



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:230791

Datë: 08.11.2023

Numri i dokumentit: 04888224

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.756/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal, gjyqtari Leon Përlaska, me procesmbajtëse Shpresa Kërnya, në çështjen penale kundër të pandehurit A. K. nga Peja, sipas aktakuzës së prokurorisë Themelore në Pejë PP/II.nr.1822/21 të datës 13.10.2021 për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.2 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 07.11.2023, në prezencë të prokurorit të shtetit Dorjan Juniku të pandehurit A. K. me mbrojtësin e tij Av.Musa Haxhiu, si dhe i dëmtuari Enver Muqolli, ne te njëjtën ditë e shpalli ndërsa me datë 08.11.2023 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

Ndaj te pandehurit:

A. K., i lindur me, në Pejë, nga i ati Bali dhe nëna Z. e vajzërisë A., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër– lëshuar nga MPB R-Kosovës, Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës.

I. REFUZOHET AKTAKUZA

Me datën 04.09.2021 rreth orës 12:30min në Pejë, përmes telefonit i kanoset seriozisht personit tjetër me fjalë se do ta privojë nga jeta dhe atë të dëmtuarit E. M. në atë mënyrë që: ditën kritike i pandehuri duke qene ne raporte familjare me te dëmtuarin e me familjen e te cilit një dite me herët kishte pasur mosmarrëveshje, ditën kritike fillimisht shkon tek stacioni i autobusëve në Pejë aty ku punon i dëmtuari dhe te njëjtin nuk e gjen aty, me pas aty e takon dëshmitarin E. M. te cilit i kërkon qe nga telefoni i tij t'ia thërret te dëmtuarin me pas përmes telefonit te njëjtin

fillimisht e fyen dhe ofendon me pas e kanos me fjalët se Ju jeni familje e poshtëre, kom me ta vra çiken me fëmijë dhe gruan, ty gjithqysh kom me te vra edhe djalin e madh, dhe ti q...fsha gjalle e te vdekur, ku kom me te nxan kom me te vra me kallash”.

- me çka kishte për të kryer veprën penale “Kanosje” nga neni 181 par 2 të KPRK-së.

II. Shpenzimet e procedurës mbeten ne barrën e mjeteve buxhetore te gjykatës.

ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Pejë me datë 13.10.2021 ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1822/21 kundër të pandehurit A. K. për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par.2 të KPRK-së.

Gjykata e mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datat 07.11.2023, në prezencë të prokurorit të shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit A. K. me mbrojtësin e tij te caktuar nga gjykata sipas detyrës zyrtare av.Musa Haxhiu, si dhe ne prezencë të të dëmtuarit E. M..

Në këtë seancë u administruan provat materiale te propozuara nga palët, u dëgjua dëshmitari E. M. si dhe u dëgjua i dëmtuari në cilësi të dëshmitarit, ku në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit u tërhoq nga akuza me arsyetimin se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është arritur të vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale qe i ngarkohet.

Si rrjedhojë gjykata mbeti pa objekt shqyrtimi, përkatësisht në këtë rast vjen në shprehje karakteri akuzator i procedurës penale, parimi “nemo iudex sine actore”, qe nënkupton se tërheqja e aktakuzës e eliminon bazën juridike për vazhdimin e gjykimit, si rrjedhojë në frymën e këtij parimi dhe në kuptim te nenit 362 par.1 pika 1.1. të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kur u vendos ne lidhje me shpenzimet e procedurës gjykata u bazua ne nenin 453 par.1 të KPPRK-së. ku thuhet “Kur pushohet procedura penale apo kur merret aktgjykimi me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilin refuzohet akuza, gjykata në aktvendim apo në aktgjykim shënon se shpenzimet e procedurës penale nga neni 449, paragrafi 2 nën-paragrafi 2.1 deri në 2.5 të këtij Kodi, shpenzimet e nevojshme të të pandehurit dhe kompensimi i shpenzimeve

të nevojshme të mbrojtësit paguhen nga mjetet buxhetore, përveç në rastet e caktuara në paragrafët vijues të këtij neni”.

Duke u bazuar ne faktet e parashtruara dhe ne baze te nenit 362 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal
P.nr.756/21, dt.08.11.2023

Gjyqtari i vetëm gjykues
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.